



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Adresa Rr. Zija Shemsiu pn, 60000 Gjiilan, Republika e Kosovës
www. uni-gjiilan.net

Rektori: Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi

Vendim.nr. 01/2428/ 22/ 12 /2020

Në bazë të nenit 48, pika 1.3 të Statutit të përkohshëm të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjiilan, Senati i Universitetit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 21.12.2020, mori:

VENDIM

Ma. Ahmet Ibrahim, zgjedhet në thirrjen akademike Ligjërues për lëndët e Artit figurativ në Fakultetin e Edukimit në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjiilan.

Emërimi është bërë në pajtim me kushtet e parapara në nenin 158 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjiilan dhe Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.

I përmenduri është i obliguar që t'u përmbahet dispozitave të Statuti të Përkohshëm të Universitetit.

Emërimi zgjatë 3/tre/vite.

Të përmendurit i takon paga në pajtim me Rregulloren për të ardhurat personale.

Kontrata e punës do të lidhet në pajtim me dispozitat pozitive.

Arsyetim

Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan ka shpallur konkurs për zgjedhjen e një mësimsdhënësi për lëndët e Artit figurativ në Fakultetin e Edukimit në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjiilan.

Komisioni recensues dhe Komisioni i studimeve i ka propozuar Senatit të Universitetit që Ma. Ahmet Ibrahim, i plotëson kushtet për t'u zgjedh në thirrjen akademike Ligjërues për lëndët e Artit figurativ.

Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan, duke i marrë për bazë vlerësimin e Komisionit Recensues dhe propozimin e Komisionit të Studimeve, vendosi që Ma. Ahmet Ibrahim, të zgjedhet në thirrjen akademike Ligjërues.

Në bazë të kësaj që u tha më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit në web faqe, Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa të Senatit të Universitetit.

Kryesuesi i Senatit

Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, rektor

Vendimi t'i dërgohet:

1. Të përmendurit
2. Zyrës së personelit
3. Arkivit të Universitetit
4. Zyrës së financave

